

VALAMAR TALE SH.P.K.
NJËSIA BASHKIAKE NR. 2, RRUGA PAPA GJON PALI
II, NDËRTEA NR. 12, KATI 11, ZYRA NR. 1100, KODI POSTAR 1010, TIRANË, SHQIPËRI
M41602022H

VENDIM

I

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 24.04.2024 në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë “Valamar Tale” Sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi M41602022H, me adresë në “Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndërtesa Nr. 12, Kati 11, Zyra nr. 1100, Kodi Postar 1010, Tiranë, Shqipëri”, (më tej referuar si “Shoqëria”), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

“Balfin-Balkan Finance Investment Group” Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa nr. 12, Kati 11, Zyra 1100, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, në datën 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 038523830, - zotërues 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë (“Ortaku i Vetëm”).

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË VALAMAR TALE SH.P.K.;

Duke kaluar në diskutimin e çështjes së parë të Rendit të Ditës, Kryetari parashtroi se për nevoja të Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej 5,041,500 (pese milion e dyzet e nje mije e peseqind) LEK. Financimi do të jepet në formën e kontributit në para të Ortakut të Vetëm me një vlerë të përgjithshme prej 5,041,500 (pese milion e dyzet e nje mije e peseqind) LEK në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga 1 000 LEK (njëmijë lekë) do të zmadhohet në 5,042,500 (pese milion e dyzet e dymije e peseqind) LEK.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë Valamar Tale sh.p.k me 5,041,500 (pese milion e dyzet e nje mije e peseqind) LEK (“Zmadhimi i Kapitalit”);
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nënshkruhet dhe është shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm në para.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga nga 1 000 LEK (njëmijë lekë) do të bëhet 5,042,500 (pese milion e dyzet e dymije e peseqind) LEK.

D. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi nëpërmjet platformes e- Albania në Qendrën Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbylljen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË
VALAMAR TALE SH.P.K.

KRYETAR


Z.NJ. EDLIRA MUKA

SEKRETAR


Z.NJ. ROZANA KODRARI

